



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 677, Datë 13.02.2020

“Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimin e Raportit Vjetor të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të :

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020,

VËREN SE :

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka depozituar Draft-Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), nenin 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar ;

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019 dhe prioritetet kryesore për vitin 2020”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS